



Partia Demokratike

Nr. 130 Prot.

Tiranë, më 01.07.2024

Lënda: Mbi efektet e vendimit nr.723, datë 11.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Z. Lulzim BASHA

DEPUTET, ISH- KRYETAR I PDSH

Tiranë

Për dijëni: Autotitetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Raiffeisen Bank Albania
Union Bank
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Tiranë

z. Deputet,

Ashtu si edhe jeni në dijëni, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me anë të vendimit nr.723 datë 11.06.2024 ka vendosur mospranimimin e ankimit ndaj Vendimit nr.3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i dhënë këtij të fundit formë të prerë dhe duke e bërë menjëherë të ekzekutueshëm. Objekti i kësaj vendimarrje certifikon ligjërisht shkarkimin tuaj si ish kryetar i Partisë Demokratike dhe bën njohjen përfundimtare të organeve të reja drejtuese dhe përfaqësuese të PDSH.

Përsa më sipër, duke konsideruar se ligjërisht efektet e vendimit nr.723 dat 11.06.2024 fillojnë menjëherë, që në datën e marrjes së tij, pavarësisht nga vënia në dispozicion e vendimit të arsyetuar, kërkojmë nga ana juaj që të merrni të gjitha masat për të ndaluar çdo lloj veprimi që ju ose të autorizuarit prej jush mund të kryeni lidhur me asetet e Partisë Demokratike të Shqipërisë që nga data 11.06.2024. Këto asetë përfshijnë por nuk kufizohen në, ambjente të marra me qera nga ana e PDSH, llogari bankare të PDSH, *domain* zyrtar i internetit të PDSH si dhe faqet zyrtare të PDSH në rrjetet sociale Facebook, Instagram, Tik Tok etj.

Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj që të mos përdorni simbolet identifikuese të PDSH të cilat me vendimarrjet e Kuvendit të 11 dhjetorit 2021 të PDSH janë shfuqizuar si dhe në komunikimin publik të mos t'i drejtoheni publikut si Partia Demokratike e Shqipërisë për sa kohë nuk keni asnjë tagër përfaqësimi.

Ftojme të caktoni përfaqësuesit tuaj që brenda tre ditëve nga marrja e kësaj shkrese të kryeni veprimet përkatëse për dorëzimin ligjor të çdo aseti të PDSH i cili ndodhet në administrimin tuaj.

Ju bëjmë me dije që administrimi i çdo aseti të PDSH që nga data 11.06.2024 është nën një monitorim të vazhdueshëm nga ana jonë dhe për çdo veprim mbi to, i cili bie ndesh me interesat e PDSH nga ana jonë do të bëhet kallzim penal në organet kompetente, SPAK, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe eventualisht do të kërkojmë dëmshpërblim në rrugë gjyqësore mbi pasuritë personale të personave përgjegjës, të cilët me veprime ose mosveprime cënojnë interesat e Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Duke ju uruar punë të mbarë,

NË EMËR TË KOMISIONIT TË RITHEMELIMIT

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I PDSH

Flamur Nolla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Nr 12570 Prot.

Tirane më 18.06.2024

VËRTETIM

Vërtetojmë se pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka ardhur për gjykim çështja civile me nr. 14000-01061-30-2022-R çështje, nr. 524 Akti, datë regjistrimi 19/03/2024, që i përket:

KERKUES: "Partia Demokratike e Shqiperise", perfaqesuar nga Komisioni i Perkohshem i Rithemelimit.

OBJEKTI: Depozitim ndryshimesh statutore dhe vendimarrje te Kuvendit Kombetar.

Me vendimin Nr.723, datë 11/06/2024 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka vendosur: Mospranimin e ankimit të ushtruar kundër vendimit Nr.3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimit mund të bëhet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit. Vendimi i arsyetuar do t'i komunikohet palëve.

Lëshohet ky vërtetim me kërkesë të kerkuesit.

KRYESEKRETARE

Rudina KAPEXHIU

